

INVESTITORI
“MetBat” SH.P.K.

Malet e Krivoves, Glllogoc



RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E
RIKUPERIMIT TË MATERIALEVE TË KLASIFIKUARA, GRUMBULLIMI,
TRAJTIMI DHE ASGJËSIMI I MBETURINAVE TË RREZIKSHME DHE JO TË
RREZIKSHME (Shtimi i Kodeve të Reja) NGA KOMPANIA “METBAT” SH.P.K.,
SANKOVC, KOMUNA GLLOGOC

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKËN E RIKUPERIMIT
TË MATERIALEVE TË KLASIFIKUARA, GRUMBULLIMI, TRAJTIMI DHE
ASGJËSIMI I MBETURINAVE TË RREZIKSHME DHE JO TË RREZIKSHME (Shtimi i
Kodeve të Reja) NGA KOMPANIA “METBAT” SH.P.K., SANKOVC, KOMUNA
GLLOGOC**

Ngastra me nr. 00265-1 dhe 00266-1, Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Glllogoc

	Emri I Investitorit
Aplikuesi	Nardi Kadriu, Person i Autorizuar
Investitori	“MetBat” SH.P.K.
Adresa:	Malet e Krivoves, Glllogoc
Lokacioni i Fabrikës	Malet e Krivoves,Sankoc, Komuna Glllogoc
Tel:	+383 44 124 280
Email:	

Investitori:

“MetBat” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com

+383 49 588 634

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	2
3.	PËR KOMPANINË.....	3
a)	Vendndodhja e Fabrikës	9
b)	Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit.....	11
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	12
d)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	14
e)	Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit të deponimi dhe djegia e mbeturinave	23
4.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME.....	25
5.	GJENDJAAKTUALE E MJEDISIT.....	26
5.1	Flora dhe Fauna.....	26
5.2	Hidrografia	27
6.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	29
6.1	Ndikimet në ajër.....	29
6.2	Ndikimet në tokë	29
6.3	Ndikimet në ujë	30
6.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	30
6.5	Ndikimet në vendbanime dhe populate.....	30
6.6	Ndikimet nga zhurma.....	30
6.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	31
6.8	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat	31
6.9	Trashëgimia Kulturore	32
7.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS	32
8.	PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	33
9.	PËRSHKRIMI I MASAVE.....	35

9.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	35
9.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	35
9.3	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë	35
9.4	Masat për mbrojtje nga zhurma	35
9.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	36
9.6	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	36
9.7	Masat për menaxhimin e mbeturinave	36
9.8	Masat rehabilituese	37
9.9	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	38
10.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE	39
11.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI.....	40
12.	PËRFUNDIM	41
13.	FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE	43
14.	LITERATURA E PERDORUR	44

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë në territorin e K. Gllogoc	10
Figura 2.	Distanca e kompanisë me qytetin e Gllogocit	10
Figura 3.	Distanca e objektit me shtëpi banimi dhe objektet tjera	11
Figura 4.	Parcela ku zhvillon aktivitetin kompania "MetBat" SH.P.K.	12
Figura 7.	Rrjeti Hidrografik i Komunës së Gllogocit	28

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Kodet e mbeturinave shtese dhe atyre ekzistuese	4
Tabela 2	Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror	31

1. HYRJE

Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shtimin e kodeve të reja të mbeturinave është një kërkesë e cila del nga Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për t'u siguruar që kompania “**MetBat**” SH.P.K., vepron në përputhje me standardet mjedisore të vendosura nga ligjet vendore dhe ndërkombëtare për menaxhimin e mbeturinave. Kjo përfshin respektimin e normave për ndotjen e ajrit, kontrollin e emisioneve dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokësore. Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis behet për arsye të shtimit të kodeve të reja të mbeturinave dhe përfshin trajtimin e llojeve të reja të mbetjeve, të cilat mund të kenë ndikime specifike në mjedis. Rikuperimi i materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme krijojnë potencialisht ndotës të ndryshëm që duhet të vlerësohen për ndikimin e tyre mbi ajrin, ujin dhe tokën.

Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mundë të paraqiten në relacionin e fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme (shtimi i kodeve të reja) nga kompania “**MetBat**” SH.P.K., Sankoc, Komuna Gllogoc, duke pasur parasysh mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë.

Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është punuar duke u bazuar në rritjen e kërkesave nga operatorët, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania tashme ka ndërtuar objektin.

Në përgjithësi, raporti i VNM-së për “**MetBat**” SH.P.K., siguron që operacionet e saj, përfshirë shtimin e kodeve të reja të mbeturinave, janë të sigurta, të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet mjedisore dhe të shëndetit publik.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme me të gjithë infrastrukturën përcjellëse dhe sipas projektit të përfunduar, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar. Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8:

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

Ligjet:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;
- Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;
- Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26;
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zjarri Nr.08/L-261

Udhëzimet Administrative:

- Udhëzim Administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave;
- Udhëzimi Administrativ (QRK)-Nr.03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 10/2015 për trajtimin e mbeturinave nga produktet medicinale
- Udhëzim Administrativ MMPH-Nr.26/2014 për menaxhimin e mbeturinave nga betërit dhe akumtatorët
- Udhëzim Administrativ Nr. 16/2013 për vlerat kufitare të përqendrimeve për komponentët e rrezikshme në mbeturina
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2013 për menaxhimin e vajrave të përdorura dhe mbeturinave me vajra
- Udhëzimi Administrativ nr. 06/2008 për administrimin e mbeturinave të rrezikshme
- Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve

në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;

- Udhëzimi Administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;

Pasi që për këtë veprimtari përdoren disa materiale që hynë tek kategoritë më të rrezikshme atëherë është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM) për Kodet shtesë, dhe për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore. Investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI).

3. PËR KOMPANINË

Kompania **MetBat Sh.p.k.** (me emër të mëparshëm **KMI Sh.p.k.**) është kompani e cila merret me grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, si dhe rikuperimin e materialeve të klasifikuara, përfshirë asgjësimin e mbetjeve spitalore dhe barnave me afat të skaduar. Kompania është e specializuar në grumbullimin, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, duke përfshirë mbetjet industriale, komunale, elektronike, plastike, metalike dhe qelqore, si dhe rikuperimin e materialeve të klasifikuara me qëllim të ripërdorimit dhe riciklimit të tyre. Një pjesë e rëndësishme e shërbimeve të saj është menaxhimi i mbetjeve spitalore dhe barnave me afat të skaduar, të cilat trajtohen dhe asgjësohen sipas standardeve teknike dhe rregulloreve mjedisore në fuqi. Duke zbatuar procedura të sigurta për grumbullimin, magazinimin e përkohshëm dhe trajtimin e këtyre mbetjeve, MetBat Sh.p.k. kontribuon në mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit, duke siguruar që proceset e saj të jenë në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Fabrika është e pajisur me teknologji për klasifikimin dhe përpunimin e mbeturinave, gjë që i lejon të jetë më eficientë në trajtimin e mbetjeve. Pasi merret me mbetje të rrezikshme, kompania ndjek standarde të rrepta për ruajtjen dhe përpunimin e tyre në përputhje me rregulloret për sigurinë e punonjësve dhe mbrojtjen e mjedisit.

Kompania “MetBat” SH.P.K. synon të minimizojë ndotjen duke ricikluar sa më shumë material dhe duke trajtuar mbetjet në mënyrë që të mos shkaktojnë dëm për mjedisin.

Kodet të cilat to të shtohet janë paraqitur në tabelën si më poshtë:

Tabela 1 Kodet e mbeturinave shitese dhe atyre ekzistuese

Tabelave e kodeve me Leje dhe Atyre shitesë të kërkuara	
02 01 04	Mbeturinat te plastikes (me përjashtim te ambalazheve)
02 01 10	Mbeturinat metalike
03 03 08	Mbeturinat nga klasifikimi i letrës dhe kartonit te destinuara për riciklim
04 01 09	Mbeturinat nga veshjet dhe procesi përfundimtar
04 02 09	Mbeturinat nga materialet e përziera (tekstil i imprenjuar elastomeri, plastomeri)
04 02 10	Lendet organike nga produktet natyrale (p.sh. yndyra, parafina)
04 02 21	Mbeturinat nga fibrat e tekstit te papërpunuara
04 02 22	Mbeturinat e fibrave te tekstit te përpunuara
06 04 03*	Mbeturinat qe përmbajnë arsen
06 04 04*	Mbeturinat qe përmbajnë merkur
06 04 05*	Mbeturinat qe përmbajnë metale te tjera te renda
07 02 13	Mbeturinat plastike
07 05 01*	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/ amë
07 05 03*	Tretësat organik te halogjenuara, lëngje për larje dhe lëngjet bazë/ amë
07 05 04*	Tretësit tjerë organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë
07 05 07*	Fundërrina të halogjenuara të distilimit dhe mbeturina te halogjenuara te reaksioneve
07 05 08*	Fundërrinat tjera të distilimit dhe mbeturinave tjera të reaksioneve
07 05 09*	Shtresat e filtrave te halogjenuara dhe absorbuesit e shpenzuar
07 05 10*	Shtresat e filtrave tjerë, absorbuesit e shpenzuar
07 05 11*	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit që përmbajnë substanca të rrezikshme
07 05 12	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit ndryshe nga ato te përmendura ne 07 05 11*
07 05 13*	Mbeturinat e ngurta që përmbajnë substanca të rrezikshme
07 05 14	Mbeturinat e ngurta ndryshe nga ato te përmendura ne 07 05 13*
07 05 99	Mbeturina te pa specifikuara ndryshe
07 06 01 *	Lëngjet ujore për larje dhe lëngjet bazë/amë
07 07 01*	

07 06 03*	Tretësat organik te halogjenuar, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë
07 07 03*	
07 06 04*	Trestesat tjera organik, lëngjet për larje dhe lëngjet bazë/amë
07 06 07*	Fundërrina te halogjenuara të distilimit dhe mbeturinat të halogjenuara te reaksioneve
07 06 08*	Fundërrinat të tjera te distilimit dhe mbeturinat te tjera te reaksionit
07 06 09*	Shtresat e filtrave të hogjenuar absorbuesit e shpenzuar
07 06 10*	Shtresat e filtrave tjerë absorbuesit e shpenzuar
07 06 11*	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit qe përmbajnë substanca te
07 07 11*	rrezikshme
07 06 12	Llumrat nga rrjedhja ne vendet e trajtimit nga ato te përmendura ne 07 06
07 07 12	11*/07 07 11*
07 06 99	Mbeturina te pa specifikuara ndryshe
07 07 99	
07 07 04 *	Tretesat tjerë organik, lëngjet për larjen dhe likuidet amë
07 07 07*	Fundërrinat halogjenike dhe llumra nga reaksionet
07 07 08*	Fundërrina te tjera dhe llumra nga reaksionet
07 07 09*	Kallëpet e filtrave halogjenike, absorbuesit e hargjuar
07 07 10*	Kallëpet e filtrave tjerë, absorbuesit e hargjuar
10 02 01	Mbeturinat nga përpunimi i llumrave
10 02 02	Llumi i papërpunuar
10 03 02	Skrapet e anodave
10 08 14	
10 03 04*	Llumrat nga prodhimi primar
10 03 05	Mbeturinat nga alumini
10 04 01*	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar
10 05 01	
10 04 02*	Shkuma nga prodhimi primar dhe sekondar
10 04 03*	Arsenati i kalciumit
10 05 08 *	Mbeturinat nga trajtimi i ujerave ftohës qe përmbajnë vajra
10 06 09*	
10 07 07*	

10 06 01	Llumrat nga prodhimi primar dhe sekondar
10 07 01	
10 08 09	Llumra tjera
10 09 03	Llumra nga furra për shkrirje
10 10 03	
10 11 03	Mbeturinat nga materialet fijeze që kanë për baze qelqin
11 05 01	Zinku i rend
12 01 01	Tallashi dhe thërmijat metalike që përmbajnë hekur
12 01 03	Tallashi dhe thërmijat e metaleve të pa ngjyrosura
12 01 05	Tallashi dhe thërmijat e plastikës
12 01 06*	Vajrat minerale të makinerive që përmbajnë halogjen (përveç emulsioneve dhe solucioneve)
12 01 07*	Vajrat minerale të makinerive që nuk përmbajnë halogjen (përveç emulsioneve dhe solucioneve)
12 01 10*	Vajrat sintetike të makinerive
12 01 12*	Parafinat dhe yndyrat e shpenzuar
12 01 13	Mbeturinat nga saldimi
12 01 14*	Llumrat e makinerive që përmbajnë substanca të rrezikshme
12 01 15	Llumrat e makinerive, tjera nga ato të përmendura në 12 01 14*
12 01 18*	Llumrat metalike (bluarjeve dhe grirjeve) që përmbajnë vajra
12 01 19*	Vajra të makinave lehtësisht të biodegradueshme
13 01 01*	Vajrat hidraulike, që përmbajnë PCB
13 01 04*	Emulsionet e kloruara
13 01 05*	Emulsionet e pakloruara
13 01 09*	Vajrat hidraulike të kloruara me baze minerale
13 01 10*	Vajrat hidraulike të pakloruara me baze minerale
13 01 11*	Vajrat hidraulike sintetike
13 01 12*	Vajrat hidraulike lehtësisht të biodegradueshme
13 01 13*	Vajrat tjera hidraulike
13 02 04*	Vajra motori ingranazhesh dhe lubrifikues të kloruara me baze minerale
13 02 05*	Vajra motori ingranazhesh/ dhëmbëzoret dhe lubrifikues të pa kloruara me baze minerale

13 02 06*	Vaje sintetik motori, ingranazhi/dhëmbëzore dhe lubrifikues
13 02 07*	Vajra lehtësisht te biodegradueshme : motori, ingrazha dhe lubrifiknati
13 02 08*	Vajra tjera motori, ingranazhi dhe lubrifikant
15 01 01	Ambalazhe letre dhe kartoni
15 01 02	Ambalazhe plastike
15 01 04	Ambalazhe metalike
15 01 05	Mbeturina ambalazhi te përbëra
15 01 06	Ambalazhe te përziera
15 01 07	Ambalazhe qelqi
15 01 09	Ambalazh tekstili
15 01 10*	Ambalazhdhe qe përmbajnë ose janë te kontaminuara me substanca te rrezikshme
15 02 02*	Absorbuesit-filtrat nga materiali (përfshir filtrat te paspecifikuara ndryshe), leckat per fshirje, veshjet mbrojtëse te kontaminuara me substanca te rrezikshme
15 02 03	Absorbuesit, filtrat nga materiali, leckat per fshirje, veshjet mbrojtëse, tjera nga ato te dhen ane 15 02 02*
16 06 01*	Bateritë e plumbit
16 06 02*	Bateritë Ni – Cd
16 06 03 *	Bateritë që përmbajnë merkur
16 04 04	Bateritë alkaline (përveç 16 06 03)
16 06 05	Bateritë dhe akumulatorët tjerë
16 07 08*	Mbeturinat që përmbajnë vaj
17 02 02	Qelqi
17 02 03	Plastika
17 02 04*	Qelqi, plastika dhe druri që përmbajnë ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme
17 04 01	Bakri, bronzi, tunxhi
17 04 02	Alumini
17 04 05	Hekuri dhe çeliku
17 04 07	Metalet e përziera
17 04 09*	Mbeturina metalike të kontaminuara me substanca të rrezikshme

18 01 01	Mjetet e mprehta (perveç 17 01 03)
18 01 03 *	Mbeturinat, mbledhja apo hudhja e të cilave kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi
18 01 04	Mbeturinat, mbledhja apo hudhja e të cilave nuk kërkon përkujdesje të posaçme në mënyrë që të parandalohet infektimi (p.sh. fasha, mbështjellës nga gipsi, çarçafat, veshjet për një përdorim, pelenat)
18 01 06 *	Kemikatet që janë apo përmbajnë substanca të rrezikshme
18 01 07	Kemikatet tjera nga ato të paraqitura në 18 01 06
18 01 08*	Ilaçet citotoksike dhe citostatike
18 01 09	Ilaçet tjera nga ato të paraqitura në 18 01 08
18 01 10*	Mbeturinat e amalgamat nga shërimi i dhëmbëve
18 02 01	Mbetjet e mbprehta (përveç 18 02 02)
18 02 02 *	Mbeturinat, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet
18 02 03	Mbeturinat, grumbullimit dhe asgjësimi i të cilave nuk kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet
18 02 05 *	Kimikate që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme
18 02 06	Kimikate, tjera nga ato të përmendura në 18 02 05
18 02 07*	Medikamentet citostatike dhe citotoksike
18 02 08	Medikamente, tjera nga ato të përmendura në 18 01 07
19 10 01	Mbeturina të hekurit dhe çelikut
19 10 02	Mbeturina të metaleve të ngjyrosura
19 12 01	Letër dhe karton
19 12 02	Metale ferore
19 12 03	Metale joferore
19 12 04	Plastikë dhe gomë
19 12 05	Qelqi
19 12 08	Tekstilet
20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelqi
20 01 08	Mbeturina të biodegradueshme nga kuzhina dhe mensat
20 01 10	Veshjet

20 01 11	Tekstili
20 01 25	Vaji dhe yndyra ushqimore
20 01 29*	Detergjentët që përmbajnë substanca të rrezikshme
20 01 30	Detergjentët, tjera nga ata të përmendura në 20 01 29
20 01 31*	Ilaçet citotoksike dhe citostatike
20 01 32	Ilaçet, tjera nga ato të përmendura në 20 01 31
20 01 33*	Bateritë dhe akumulatorët e përfshirë në 16 06 01, 16 06 02 ose 16 06 03 dhe bateritë dhe akumulatorët e pandarë
20 01 34	Bateritë dhe akumulatorët, tjera nga ato të paraqitura në 20 01 33*
20 01 35*	Paisjet elektrike dhe elektronike për hudhje, tjera nga ato të përmendura në 20 01 21, 20 01 23 dhe 20 01 35
20 01 39	Plastika
20 01 40	Metalet
20 02 01	Mbeturinat që mund të kompostohen
20 02 03	Mbeturinat tjera jo bio degraduese
20 03 01	Mbeturina e përziera komunale
20 03 02	Mbeturina nga tregjet
20 03 03	Mbeturinat nga pastrimet e rrugëve

Ne tabelën e mësipërme janë paraqitur Kodet e mbeturinave sipas U.A. Nr. 13 /2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave, ku për disa prej tyre kompania ka Pëlqim dhe Leje Mjedisore.

a) Vendndodhja e Fabrikës

Objekti i fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo te rrezikshme ndodhet në ngastrën kadastrale me nr. 00265-1 dhe 00266-1, Zona kadastrale Sankoc, Komuna Gllogoc.

Fshati Sankoc kufizohet me fshatrat e komunës së Gllogocit siç janë: Korreticë e Epërme, Zabel i Ulët, Zabel i Epërm, Komoran, Fushticë e Poshtme, Fushticë e Epërme, me fshatrat e komunës se Fushë Kosovës si: Sllatina e Madhe, Harilaq dhe komunën e Lipjan: fshati Mirenë. Territori i komunës së Gllogocit shtrihet në pjesën e Kosovës qendrore. Sipërfaqja e gjithmbarshme e kësaj komune përfshinë 290 km² apo 2.66 % të sipërfaqes së territorit të Kosovës. Gjithë kjo trevë ,e cila përbëhet nga 42 vendbanime është e rrethuar me Malet e Berishës, Kasmaqit, Qyqavicës, Goleshit dhe Lipovicës(Blinajës).




Figura 1. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë në territorin e K. Gllgoc




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Gllgocit

Në afërsi të “MetBat” SH.P.K., fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme Sankoc, Gllgoc, të gjitha objektet janë me aktivitet industrial, dhe nuk ka shtëpi të banimit në afërsi.



Figura 3. Distanca e objektit me shtëpi banimi dhe objektet tjera

Shtëpia me afërt gjendet mbi 1.4 km largët, ndërsa biznesi me i afërt është afërt tije, ku objekti nga objekti është në një distance prej 40 m largët.

b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit

Për kompaninë, “MetBat” SH.P.K. më poshtë do të paraqesim veçoritë fizike të këtij projekti:

Objekti për mbeturina jo të rrezikshme – me sipërfaqe rreth $S = 3300 \text{ m}^2$, është i ndërtuar me konstruksion metalik, llamarinë, me dyshe me betoni dhe kulme nga llamarina. Në këtë objekt janë të instaluar vijat teknologjike të përpunimit, rikuperimit dhe magazinimit të metalit, plastikës, letrës dhe qelqit. Kjo ndihmon në uljen e sasisë së mbeturinave të cilat do të shkonin për asgjësim dhe kontribuon në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.

Objekti për mbeturina të rrezikshme – me sipërfaqe rreth $S = 2270 \text{ m}^2$, objekti është ndërtuar me konstruksion metalike, llamarine, me dyshe me betoni dhe kulme nga llamarina. Në këtë objekte janë instaluar vijat e teknologjisë për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme duke përfshirë neutralizimin dhe asgjësimin e substancave kimike ose të tjera të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin. Pajisjet moderne dhe teknologjia e avancuar garantojnë një trajtim të sigurt për këto mbetje. Këto objekte nuk janë në gjendje me të mirë.

Objekti për grumbullimin e mbeturinave - me sipërfaqe rreth $S = 1000 \text{ m}^2$, objekti është ndërtuar me konstruktion metalike, llamarine, me dysHEME nga betoni dhe kulme nga llamarina.

Objekti i administratës - me sipërfaqe rreth $S = 200 \text{ m}^2$, objekt është ndërtuar me konstruktion metalike, llamarine, me dysHEME nga betoni dhe kulme nga llamarina. Objekti i administratës përbehej prej zyrave të personelit, kuzhina për ushqim, holli për pushim dhe banjo për nevojat e punëtorëve.




Figura 4. Parcela ku zhvillon aktivitetin kompania "MetBat" SH.P.K.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Faza operative e projektit përfshin aktivitetet e përditshme të menaxhimit të mbeturinave, të cilat zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar, duke siguruar që të gjitha mbeturinat të trajtohen në përputhje me natyrën dhe kategorinë e tyre. Ky proces zhvillohet përmes disa komponentëve kryesorë si:

Pranimi dhe regjistrimi i mbeturinave: Çdo mbetje që pranohet në objekt identifikohet, peshohet dhe regjistrohet në sistemin e kompanisë, pastaj mbeturinat klasifikohen sipas **Katalogut Shtetëror të Mbeturinave**, duke u ndarë në mbetje të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, dhe në fund kryhet inspektimi vizual.

Magazinimi i përkohshëm : Mbeturinat e rrezikshme ruhen në kontejnerë të mbyllur hermetikisht dhe të etiketuar sipas UA 03/21. Mbeturinat jo të rrezikshme vendosen në hapësira të ndara dhe të mbuluara për të shmangur ndotjen e tokës dhe ujërave. Ndërsa për mbeturinat spitalore dhe barnat me afat të skaduar përdoren dhoma të posaçme me kushte higjieno-sanitare dhe temperatura të kontrolluara.

Trajtimi dhe Asgjësimi i Mbeturinave: **Mbeturinat jo të rrezikshme** (plastike, letër/karton, qelq, metale) i nënshtrohen proceseve të seleksionimit, presimit dhe paketimit për rikuperim dhe riciklim. **Mbeturinat e rrezikshme** (bateritë, vajrat e përdorura, mbetjet kimike) trajtohen me metoda të kontrolluara, duke u neutralizuar ose përgatitur për asgjësim të sigurt. **Mbeturinat spitalore dhe farmaceutike** i nënshtrohen procesit të asgjësimit përmes incinerimit ose sterilizimit termik, duke garantuar eliminimin e rrezikut biologjik. Jo çdo mbetje mund të asgjësohet plotësisht nga kompania. Për shembull, disa mbetje toksike, hiri i mbetur nga incinerimi, ose mbetje të veçanta kimike kërkojnë depozitim në deponi të specializuara të licencuara. Në këto raste, kompania, pasi ka kryer procesin e trajtimit primar (p.sh. grumbullim, paketim, djegie ose neutralizim), i dorëzon mbetjet përfundimtare tek një operator tjetër i autorizuar për deponim final.

Masat për mbrojtjen e mjedisit: Gjatë fazës operative, projektit përfshin teknologji për të kontrolluar emetimet dhe për të trajtuar ujërat e ndotura që rezultojnë nga proceset e përpunimit. Këto masa ndihmojnë në reduktimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit përreth fabrikës. Implementimi i sistemeve për filtrimin e ajrit dhe zvogëlimin e pluhurit dhe zhurmës, menaxhimi i ujërave të ndotura përmes grumbullimit në gropa septike dhe dërgimit për trajtim, rregullimi i hapësirave për mbjellje të gjelbërimit për reduktim të ndikimeve vizuale dhe ekologjike.

Monitorimi, Siguria dhe Kontrolli i Cilësisë: Gjatë operacioneve të përpunimit, kryhet monitorim i vazhdueshëm për të siguruar që proceset përmbushin standardet e sigurisë dhe të cilësisë. Testimi dhe analizat e materialeve kryhen rregullisht për të verifikuar përputhjen me kërkesat mjedisore. Çdo proces shoqërohet me mbajtjen e **regjistrave të mbeturinave**, ku evidentohen lloji, sasia, origjina dhe mënyra e trajtimit. Punonjësit pajisen me pajisje personale mbrojtëse (PPE) dhe trajnohen për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme.

Transporti i Sigurt i Mbeturinave: Faza operative përfshin gjithashtu një proces të mire organizuar për transportin e mbetjeve nga vendet e grumbullimit deri te fabrika. Ky proces i logjistikës ndihmon në mbrojtjen e mbetjeve gjatë transportit dhe siguron që ato të mbërrijnë në fabrikë në gjendje të sigurt për trajtim të mëtejshëm.

Këto veçori operative ndihmojnë në sigurimin e një procesi efikas, të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit, duke i mundësuar kompanisë të trajtojë mbetjet në përputhje me standardet më të larta mjedisore dhe të sigurisë.

d) Përshkrimi detaj i procesit teknologjik

Proceset teknologjike të kompanisë MetBat Sh.p.k. përfshijnë grumbullimin, transportin, klasifikimin, trajtimin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, si dhe asgjësimin e mbeturinave medicinale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe standardet mjedisore. Për çdo kategori mbetjesh aplikohen këto procedura:

1. Përshkrimi i detajuar i procesit teknologjik për mbetje jo të rrezikshme si (plastika, letër/karton, qelq, metale)

Procesi teknologjik për trajtimin e mbetjeve jo të rrezikshme zhvillohet në disa faza të ndërlidhura, duke filluar nga pranimi i mbetjeve deri tek përgatitja për transport ose riciklim. Më poshtë paraqitet përshkrimi hap-pas-hapi:

Pranimi dhe peshimi i mbeturinave - Të gjitha mbetjet që arrijnë në qendër regjistrohen dhe peshohen në peshore elektronike, në këtë fazë bëhet verifikimi i llojit të mbetjeve për të siguruar që ato janë jo të rrezikshme.

Shkarkimi dhe inspektimi vizual - Mbetjet shkarkohen në hapësirat e dedikuara (zona e pranimit), dhe kryhet kontroll vizual për ndarjen paraprake të materialeve të papërshtatshme ose kontaminuara.

Klasifikimi dhe ndarja fillestare - Mbetjet ndahen manualisht dhe mekanikisht sipas llojit: Plastika (PET, HDPE, PP etj.), Letër, Karton, Qelq, dhe Metale (hekur, alumini etj.) Ndarja bëhet duke përdorur rripa transportues, sita mekanike, dhe punëtorë të trajnuar për seleksionim.

Përpunimi specifik sipas materialit:

- **Plastika** – Procesi i përpunimit të mbetjeve plastike përfshin disa hapa teknikë të strukturuar, të cilët e shndërrojnë mbetjen e papërpunuar në material të përshtatshëm për riciklim ose ripërdorim. Plastika e mbledhur pranohet në objekt dhe peshohet në peshore elektronike, dhe regjistrohet sasia dhe lloji i tyre. Plastika ndahet sipas llojit të polimerit: PET, HDPE, PP, PVC etj, behet edhe ndarja sipas ngjyrës: transparent, e bardhë, e ngjyrosur. Pastaj hiqen materialet e huaja si kapakë,

etiketa, metale, qelq etj. Plastika shpëlahet me ujë të ngrohtë ose të ftohtë për heqjen e papastërtive, vajrave dhe ngjitësve, ku përdoren detergjente të biodegradueshëm, pastaj thahet me centrifuga ose tharëse ajri. Pas tharjes plastika futet në makina prerëse (shredder/granulator), ndërsa shishet, qeset dhe mbetjet tjera shtypet në presa hidraulike për të formuar balle/dange, të cilat lidhen me shirita metalikë ose plastikë për stabilitet. Plastika e grimtuar ose e shtypur ruhet në depo të mbuluara, dhe sigurohet ndarja sipas kategorive për të shmangur përzierjet. Pasi që kjo kompani nuk merret me riciklim të gjitha plastika e përpunuar dërgohet në fabrikat e riciklimit.

- **Letër/Karton** - Procesi teknologjik i trajtimit të mbetjeve të letrës dhe kartonit është i fokusuar në ndarjen, reduktimin e volumit dhe përgatitjen për riciklim. Mbetjet e letrës dhe kartonit pranohen në objekt dhe peshohen në peshore elektronike, regjistrohet sasia dhe lloji i mbetjeve të ardhura. Behet ndarja fillestare për të larguar materialet e huaja: plastika, metale, qelqi, tekstile, ushqime apo mbetje organike, pastaj letra dhe kartoni ndahet sipas llojit: Letër e bardhë (zyrtare, printeri, fotokopje), Karton i valëzuar (pako, kuti transporti), Karton i thjeshtë (ambalazh, mbështjellës), Letra të përziera (revista, gazeta, broshura). Në rastet kur letra/kartoni ka ndotje nga boja, ngjitësi apo yndyra, kryhet pastrim paraprak dhe shpëlarja bëhet me ujë dhe detergjentë të lehtë për të lehtësuar procesin e mëvonshëm të riciklimit. Letra dhe kartoni vendosen në presa hidraulike për të formuar balle/dange me përmasa të standardizuara, ky proces redukton ndjeshëm volumin dhe mundëson ruajtje të transportit. Lidhja e ballev/dange bëhet me shirita metalike ose plastik për stabilitet. Ballet/dange të letrës dhe kartonit ruhen në depo të thata dhe të mbuluara për të shmangur lagështinë, e cila e dëmton materialin, dhe pas grumbullimit të sasive të mjaftueshme, balet transportohen tek fabrikat e riciklimit.
- **Qelqi** - Procesi i trajtimit të mbetjeve të qelqit është i ndërtuar për të siguruar ndarjen, pastrimin dhe përgatitjen e materialit në mënyrë që të shërbejë si lëndë e dytë në industrinë e riciklimit. Mbetjet e qelqit pranohen në qendër në zonën e dedikuar për pranim dhe peshohen në peshore elektronike, bëhet regjistrimi i sasisë dhe lloji i qelqit (shishe, kavanoza, mbetje industriale), dhe kryhet kontrolli për të larguar materiale të huaja si: plastika, metale, kapakë, tapa, tekstile apo mbetje organike. Pas kësaj bëhet ndarja e qelqit, e cila ndahet sipas ngjyrës: Transparent (i

bardhë), Jeshil, Kafe, ndarja mund të bëhet manualisht ose me sisteme optike automatike. Pas kësaj shishet dhe kavanozat futen në makina thyerëse (crusher) për t'u reduktuar në copa të vogla, në përmasa standarde 10-50mm, varësisht nga kërkesat e industrisë përpunuese. Grimcat e qelqit, kalojnë në proces sitjeje dhe larjeje për të larguar: Pluhurin, papastërtitë organike, ngjitësit dhe mbetjet e etiketave. Për pastrim përdoren sisteme me ajër të kompresuar dhe ujë me presion për pastrim efektiv. Qelqi i grimcuar ruhet në kontejnerë metalikë ose silosë të mbyllur për të shmangur ndotjen dhe përzierjen, ku secila kategori e ngjyrës ruhet veçmas. Në fund kur arrihet sasia e duhur, qelqi i grimcuar transportohet në fabrikat e riciklimit të qelqit.

- **Metalet** - Procesi teknologjik i përpunimit të mbetjeve metalike (hekur, alumin, bakër, çelik, etj.) është i ndërtuar për të rikuperuar dhe përgatitur materialin për riciklim ose shkrirje industriale. Mbetjet metalike pranohen në qendër në hapësirat e dedikuara të magazinimit, peshohen në peshore elektronike, dhe regjistrohet sasia dhe lloji i metaleve të pranuara. Pastaj kryhet inspektim vizual për të larguar materiale të huaja: plastika, qelqi, goma, tekstile apo pjesë të përziera. Pas kësaj metalet ndahen sipas llojit: Ferromagnetike (hekur, çelik) – ndahen me separatorë magnetikë, Jo-ferromagnetike (alumin, bakër, bronz) – ndahen me sensorë optikë ose ndarës, ndarja mund të bëhet edhe në mënyrë manuale. Pjesët e mëdha metalike futen në shredder industrial për t'u reduktuar në copa më të vogla, ndërsa elementet voluminoze (tuba, profile, pjesë makinash) shtrydhen në presa hidraulike për të zvogëluar dimensionet. Metali i përzgjedhur dhe i grimcuar futet në presa për të formuar balle (dange) në përmasa të standardizuara, dhe lidhen me shirita metalikë për qëndrueshmëri. Metalet ruhen në hapësira të mbuluara ose kontejnerë të dedikuar sipas kategorisë (alumin, hekur, bakër etj.). Sigurohet ndarja e tyre për të ruajtur cilësinë dhe për të shmangur oksidimin e tepërt.

1. Procesi teknologjik i mbeturinave të rrezikshme

Procesi teknologjik për neutralizimin dhe asgjësimin e substancave kimike ose të tjera të rrezikshme në kompaninë "MetBat" SH.P.K. është projektuar për të trajtuar mbetjet që përmbajnë kimikate të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin publik. Ky proces siguron që substancat kimike të degradohen ose të bëhen inerte përpara se të eliminohen përfundimisht. Përshkrimi i detajuar i këtij procesi përfshin hapat e mëposhtëm:

Pranimi dhe Identifikimi : Mbetjet klasifikohen sipas katalogut shtetëror të mbeturinave:

- Mbetje medicinale/farmaceutike
- Bateri dhe akumulatorë
- Vajra dhe lubrifikantë të përdorur
- Kimikate të rrezikshme (tretës, pesticide, ngjyra, ngjitës)
- Pajisje elektrike/elektronike me substanca të rrezikshme

Çdo kategori do të trajtohet veçmas për të shmangur reaksione të rrezikshme.

Magazinishi i përkohshëm : Hapësira e magazinimit duhet të jetë e ndarë fizikisht nga mbeturinat e tjera dhe nga ambientet e punës, të ketë shtresë mbrojtëse (beton, asfalt ose membranë te papërshkueshëm nga uji) për të parandaluar rrjedhjet në tokë, të jetë e mbuluar për mbrojtje nga shiu, era dhe dielli dhe duhet të ketë ventilim të mjaftueshëm për shmangien e grumbullimit të gazrave. Gjithashtu objekti duhet të jetë i pajisur me sisteme kundër zjarrit , (hidrant, fikës zjarri, sensore tymi).

Mbeturinat ruhen vetme në kontejner metalik ose plastike të qëndrueshëm, kontejner hermetik ose cisterna të aprovuara. Çdo kontejner duhet të jetë i mbyllur fort për të parandaluar rrjedhje dhe avullime. Etiketimi i detyrueshëm me: emrin e mbetjes, kodin sipas katalogut, piktogramin e rrezikut dhe datën e pranimit.

Mbetjet duhet të ruhen të ndara sipas tipit (kimikate, vajra, bateri, mbetje spitalore, farmaceutike), nuk lejohet përzierja e mbetjeve që mund të reagojnë kimikisht. Sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikës në Kosovë, mbetjet e rrezikshme nuk mund të ruhen për më shumë se 6–12 muaj pa trajtim ose dorëzim final. Për mbeturinat spitalore, magazinimi lejohet vetëm për pak ditë deri maksimumi 1 muaj, varësisht kushteve të ruajtjes.

Bateritë dhe akumulatorët: ruhen në paleta plastike ose kontejnerë të mbyllur, të mbrojtur nga lagështia.

Barnat e skaduara: ruhen në kuti të forta, në ambiente të ventilueshme dhe me qasje të kufizuar.

Mbetjet spitalore infektive: magazinohen në dhoma frigoriferike me temperaturë të kontrolluar deri në momentin e incinerimit.

Vajrat e përdorur: ruhen në cisterna metalike me dysheme me barrierë kundër rrjedhjeve.

Kimikate të rrezikshme (tretës, pesticide, ngjyra, ngjitës): ruhen gjithmonë në kontejnerë hermetikë dhe rezistentë ndaj korrozionit, të shënuar me etiketa paralajmëruese, duke treguar qartë përbërjen, rrezikun dhe datën e magazinimit.

Pajisje elektrike/elektronike me substanca të rrezikshme : Magazinimi i përkohshëm bëhet në depo të mbyllura, të mbuluara dhe të sigurta nga kushtet atmosferike, me dyshe me të papërshkueshëm nga uji për të parandaluar infiltrimin në tokë. Pajisjet ruhen të papërziera dhe të paprishura mekanikisht, për të shmangur lirim të substancave të rrezikshme.

Magazinimi i mbetjeve të rrezikshme nuk është thjesht ruajtje, por një proces i kontrolluar që ka për qëllim parandalimin e derdhjeve, ndotjes dhe rrezikut për shëndetin deri në asgjësimin.

Procesi teknologjik i trajtimit të baterive dhe akumulatorëve: përfshin disa hapa të ndërlidhur që sigurojnë menaxhimin e sigurt dhe rikuperimin e materialeve të vlefshme. Fillimisht, bateritë dhe akumulatorët pranohen në objekt, peshohen, regjistrohen dhe kontrollohen për gjendjen e tyre. Pas pranimit, ato magazinohen përkohësisht në hapësira të veçanta mbi paleta plastike ose metalike, në kontejnerë të mbyllur dhe të mbrojtur nga rrjedhjet, duke u ndarë sipas tipit për të shmangur reaksionet e padëshiruara kimike. Procesi i trajtimit fillon me çmontimin manual dhe mekanik, ku hiqen mbështjellësit dhe bateritë ndahen në përbërësit kryesorë si plumbi, plastika dhe elektroliti. Më pas, përmes metodave të ndarjes fizike si flotacioni ose graviteti, plumbi ndahet nga fraksionet plastike. Elektroliti, zakonisht acid sulfurik, neutralizohet me reagentë bazikë (gëlqere ose sodë kaustike) duke u kthyer në sulfat kalciumi ose trajtohet për riciklim. Plumbi i nxjerrë i nënshtrohet proceseve të shkrirjes pirometalurgjike ose hidrometalurgjike për të rikuperuar metalin që përdoret sërish në prodhimin e baterive të reja. Në rastin e baterive të tjera, si ato Ni-Cd ose Li-ion, rikuperohen metale specifike përmes proceseve elektrolitike ose kimike. Në fund, sedimentet dhe mbetjet dytësore klasifikohen si mbetje të rrezikshme dhe dorëzohen në deponi të licencuara. Ky proces siguron rikuperimin deri në 95% të plumbit, duke zvogëluar ndjeshëm ndikimet mjedisore dhe duke kthyer një mbetje të rrezikshme në burim të vlefshëm për industri.

Procesi teknologjik për trajtimin e barnave të skaduara dhe mbetjeve medicinale: fillon me pranimin e tyre në objekt, ku ato regjistrohen sipas origjinës, sasisë dhe llojit, duke u shoqëruar me fletë përcjellëse dhe dokumentacionin përkatës. Barnat e skaduara dhe mbetjet medicinale paketohen në kuti ose kontejnerë të fortë, të mbyllur hermetikisht, të shënuar me kode identifikuese dhe me shenjën paralajmëruese të rrezikut biologjik apo kimik, në përputhje

me kërkesat ligjore. Para trajtimit, këto mbetje magazinohen në ambiente të posaçme, të sigurta dhe të ventilueshme, ndërsa mbetjet spitalore infektive dhe farmaceutike ruhen në dhoma frigoriferike në temperatura të kontrolluara deri në momentin e asgjësimit. Procesi i asgjësimit kryhet përmes incinerimit në temperatura të larta mbi 1100°C, që siguron shkatërrimin e plotë të substancave farmaceutike aktive, eliminimin e agjentëve patogjenë dhe reduktimin drastik të vëllimit të mbetjeve. Gjatë incinerimit, krijohen gazra të cilët kalojnë përmes sistemeve të filtrimit dhe pastrimit për të reduktuar emisionet e dëmshme në ajër, ndërsa hiri dhe mbetjet inerte të mbetura mblidhen, paktohen në kontejnerë të mbyllur dhe dorëzohen për deponim të sigurt në deponi të licencuara për mbetje të rrezikshme. Ky proces siguron neutralizimin e rrezikut biologjik dhe kimik, eliminon mundësinë e hyrjes së barnave të skaduar në treg ose në mjedis dhe garanton mbrojtjen e shëndetit publik dhe mjedisit.

Incinerimi është një proces teknologjik i djegies së kontrolluar të mbetjeve në temperatura shumë të larta (zakonisht 850°C – 1200°C), me qëllim asgjësimin e plotë të përbërjeve të rrezikshme, zvogëlimin e vëllimit të mbeturinave dhe neutralizimin e rrezikut biologjik e kimik. Ky proces është i domosdoshëm për mbetjet spitalore, mbetjet farmaceutike dhe disa fraksione të tjera të rrezikshme që nuk mund të riciklohen ose deponohen në mënyrë të zakonshme. Incinerimi behet me dy dhoma djegie. Mbetjet futen në dhomën e djegies ku ndodhet flaka kryesore me temperaturë nga 850 -1100 °C, në këtë fazë shkatërrohen përbërjet organike, substancat toksike dhe agjentët patogjenë, vëllimi i mbetjeve reduktohet deri në 90%. Pas kësaj, gazrat e prodhuar në fazën e parë kalojnë në dhomën e djegies sekondare ku digjen plotësisht, në temperaturë me te madhe se 1100 °C. Kjo siguron eliminimin e mbetjeve të padjegura dhe zvogëlimin e emisioneve të dëmshme. Mbas këtij procesit mbetet hir i ngurtë (10–15% e masës fillestare), i cili klasifikohet si mbetje e rrezikshme dhe ruhet në kontejnerë hermetikë, dhe dorëzohet tek deponit e licencuara për mbetje të rrezikshme.

Procesi teknologjik për trajtimin e vajrave të përdorur: fillon me grumbullimin e tyre nga serviset, industritë dhe burime të tjera gjeneruese, ku secila sasi regjistrohet sipas origjinës dhe llojit. Pas pranimit, vajrat e përdorur ruhen në cisterna ose kontejnerë të mbyllur hermetikisht, të vendosura mbi dysheme të papërshkueshme nga lëngjet, për të shmangur rrjedhjet dhe ndotjen e tokës ose ujërave nëntokësore. Para trajtimit kryhet procesi i përpunimit paraprak që përfshin dekantimin dhe filtrimin për largimin e papastërtive të ngurta, si dhe ndarjen e ujit dhe sedimentit. Në fazën e trajtimit kryesor, vajrat i nënshtrohen procesit të redestilimit, ku përmes ngrohjes në temperatura të kontrolluara ndahen fraksionet e vlefshme që pastaj

rifreskohen me aditivë dhe shndërrohen në vaj bazë për prodhimin e lubrifikantëve të rinj ose në karburant alternativ për industri. Gjatë procesit kryhen gjithashtu degazimi dhe neutralizimi kimik për të larguar komponimet e padëshiruara dhe aciditetin e tepërt. Fraksionet e papërdorshme dhe mbetjet dytësore (sedimente, hiri, emulsione) klasifikohen si mbetje të rrezikshme dhe dorëzohen në deponi të licencuara për trajtim final. Ky proces siguron rikuperimin e substancave me vlerë, zvogëlimin e ndotjes mjedisore nga derdhjet e pakontrolluara dhe kthimin e vajrave të përdorur në burim të vlefshëm për ekonominë rrethore.

Regjenerimi : është një proces i trajtimit të mbetjeve me qëllim ripërdorimin e përbërësve të vlefshëm, rikthimin e tyre në qarkullim si lëndë të para sekondare dhe zvogëlimin e nevojës për deponim final. Ky proces ka rëndësi të veçantë për ekonominë rrethore, pasi minimizon gjenerimin e mbetjeve dhe ul ndotjen mjedisore.

Se pari behet përpunimi paraprak si : Filtrimi dhe dekantimi, ku behet largimi i sedimentuesve, grimcave të ngurta dhe ujit të pranishëm, pas kësaj behet Centrifugimi ku ndahet faza e vajit nga përbërësit e ngurtë dhe emulsioni. Pas kësaj fillojmë me procesin e regjenerimit , i cili fillon me Destilimin apo Redestilimin ku vajrat dhe tretësit nxehen në temperatura të larta për të ndarë fraksionet sipas pikës së vlimit, fraksionet e pastra rikuperohen dhe mund të përdoren si vajra bazë për lubrifikantë të rinj ose si tretës teknikë. Vazhdon me degazimin dhe pastrimin kimik ku hiqen gazrat e tretur dhe komponimet e paqëndrueshme, dhe përdoren reagente për neutralizimin e acideve dhe stabilizimin e produktit. Proces i tjetër pas degazimit është aditivimi apo rifreskimi ku, vaji dhe lubrifikantët e rikuperuar përmirësohen me aditivë të rinj (antioksidantë, detergjentë, përmirësues të viskozitetit), ku kjo i kthen në produkte funksionale për përdorim industrial. Pas këtyre proceseve nëse pastërtia është e lartë, mund të përdoren sërish në industri kimike ose laboratorike.

Procesi teknologjik për kimikatet e rrezikshme (tretës, pesticide, ngjyra, ngjitës):

Kimikatet e rrezikshme, për shkak të vetive toksike, korrozive, inflamabile dhe ndonjëherë mutagjene, i nënshtrohen një procesi teknologjik të kontrolluar që fillon me pranimin dhe identifikimin e tyre përmes dokumentacionit përcjellës ose analizave laboratorike kur mungojnë të dhënat. Pas regjistrimit, ato ruhen në kontejnerë hermetikë të etiketuar qartë dhe vendosen në depo të mbuluara me dyshe me papërshkueshëm nga uji, ventilim dhe mbrojtje kundër zjarrit, duke respektuar ndarjen e substancave të papajtueshme. Trajtimi zhvillohet sipas natyrës së kimikateve: tretësit organikë i nënshtrohen distilimit ose rigjenerimit për ripërdorim, ndërsa fraksionet e tjera digjen në inkineratorë me temperaturë mbi 1,100 °C dhe

me sisteme filtrimi për mbrojtje të ajrit. Acidet dhe bazat e forta neutralizohen përmes reaksioneve kimike deri në arritjen e një pH të sigurt, ndërsa mbetjet e lëngëta ose llumrat që nuk kanë trajtim tjetër stabilizohen dhe solidifikohen me materiale lidhëse si çimento apo gëlqere për t'u kthyer në formë të ngurtë. Në fund, mbetjet që nuk mund të rigjenerohen ose neutralizohen dërgohen në deponi të specializuara për mbetje të rrezikshme, të pajisura me membrana mbrojtëse, sisteme për mbledhjen e lixiviatit dhe monitorim të vazhdueshëm të ujërave nëntokësore.

Procesi teknologjik për pajisje elektrike/elektronike me substanca të rrezikshme: Pajisjet elektrike dhe elektronike që përmbajnë substanca të rrezikshme i nënshtrohen një procesi të kontrolluar, i cili fillon me pranimin, regjistrimin dhe peshimin e tyre për të siguruar gjurmueshmërinë e plotë. Pas pranimit, ato ruhen përkohësisht në depo të mbuluara, dysheme e papërshkueshëm nga uji dhe të venteluar, duke shmangur ekspozimin ndaj lagështisë dhe duke u vendosur në paleta ose kontejnerë të shënuar me etiketa paralajmëruese. Më pas, pajisjet i nënshtrohen procesit të çmontimit, ku ndahen komponentët kryesorë si plastika, metalet, qarkoret elektronike, kabllot dhe pjesët që përmbajnë substanca të rrezikshme si bateri, akumulatorë, llamba me merkur, kondensatorë me PCB ose gazra ftohës CFC/HCFC. Substancat e rrezikshme hiqen me kujdes dhe dërgohen për trajtim të posaçëm, ndërsa pjesët e tjera me vlerë si metalet dhe plastika përgatiten për riciklim. Në fazën tjetër kryhet rigjenerimi i tretësve dhe metaleve të çmuara nga qarkoret, shkrirja e metaleve ferromagnetike dhe jo-ferromagnetike, si dhe riciklimi i plastikës sipas kategorive. Fraksionet që nuk mund të riciklohen ose të rigjenerohen stabilizohen me materiale lidhëse dhe dërgohen në deponi të posaçme për mbetje të rrezikshme. Ky proces siguron riciklimin e materialeve të vlefshme, trajtimin e kontrolluar të substancave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit nga ndotja.

Mbetjet e rrezikshme, të tilla si mbetjet medicinale, kimikatet, tretësit organikë, vajrat e përdorur, bateritë, akumulatorët dhe mbetjet me metale të rënda, pas trajtimit të detajuar (incinerim, neutralizim kimik, stabilizim/solidifikim ose riciklim i metaleve/vajrave), dorëzohen në objekte të posaçme për deponim final. Këto deponi për mbetje të rrezikshme kanë shtresa të shumëfishta izolimi me membranë HDPE, sistem drenazhimi për mbledhjen e ujërave të kontaminuara, mbikëqyrje të vazhdueshme të gazrave dhe ujërave nëntokësore, si dhe barriera inxhinierike për të parandaluar çdo rrjedhje në mjedis.

- **Solidifikimi dhe Stabilizimi i mbetjeve të rrezikshme :** Për mbetjet që janë ende të rrezikshme pas trajtimit, aplikohet procesi i solidifikimit. Kimikatet i nënshtrohen shtimit

të materialeve lidhëse, si çimento apo substanca të tjera ngjitëse, për t'i kthyer në një masë të ngurtë që është më e sigurt për deponim. Ndërsa për Stabilizimin Kimik: Përdoren substanca të ndryshme për të stabilizuar mbetjet dhe për të bllokuar ndotësit, në mënyrë që të reduktohet rreziku i kontaminimit. Kjo ndihmon për ta bërë të sigurt përfundimisht asgjësimin ose deponimin e mbetjeve.

Trajtimi i Gazrave dhe Emetimeve: Trajtimi i gazrave dhe emetimeve është një proces thelbësor për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe mbrojtjen e shëndetit publik, i cili zbatohet gjatë incinerimit të mbetjeve, trajtimeve kimike dhe proceseve industriale. Fillimisht, gazrat që krijohen në këto procese mblidhen dhe kanalizohen drejt sistemeve të filtrimit, ku hiqen grimcat e ngurta me ciklone, filtra mekanikë ose filtra me qese. Për gazrat acidikë si HCl, SO₂ dhe HF përdoren scrubber-a të lagësht ose neutralizim kimik me gëlqere dhe karbonat kalciumi, ndërsa për komponimet organike të paqëndrueshme, dioksinat dhe furanët aplikohen oksidimi katalitik dhe filtrat me karbon aktiv. Në incinerimin e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore, para filtrimit, gazrat kalojnë në një fazë djegieje dytësore në temperatura mbi 1,100 °C për të siguruar shkatërrimin e plotë të komponimeve organike. Në industrinë metalurgjike ose riciklimin e metaleve përdoren gjithashtu filtra elektrostatikë dhe scrubber-a me qarkullim uji për të larguar metalet e rënda si plumbi dhe kadmiumi. Gjithë procesi shoqërohet me monitorim të vazhdueshëm përmes sistemeve CEMS, të cilat matin parametrat kryesorë si CO₂, CO, NO_x, SO₂, pluhuri dhe komponimet organike, duke i krahasuar me kufijtë e lejuar nga legjislacioni vendor dhe direktivat e BE-së. Në fund, gazrat e trajtuar lëshohen në atmosferë përmes oxhaqeve të larta, duke siguruar shpërndarjen e kontrolluar dhe respektimin e standardeve mjedisore.

Menaxhimi i Ujërave të Ndotura: Trajtimi i Ujërave: Ujërat e ndotura që rezultojnë nga proceset kimike trajtohen në impiante specifike për trajtimin e ujit. Prosesi përfshin filtrimin, dekantimin, dhe pastrimin biologjik ose kimik për të hequr ndotësit e rrezikshëm përpara se të shkarkohen. Para shkarkimit, ujërat testohen për përmbajtje toksike dhe parametra të tjerë të sigurisë, duke siguruar që janë në përputhje me standardet mjedisore.

Deponimi dhe dorëzimi final i mbetjeve (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme): Prosesi i deponimit dhe dorëzimit final është faza e fundit në menaxhimin e mbetjeve dhe ka për qëllim sigurimin që mbetjet, pas trajtimit ose riciklimit, të eliminohen në mënyrë të sigurt, pa shkaktuar ndotje në mjedis apo rrezik për shëndetin publik.

Mbetjet jo të rrezikshme (plastika, letër/karton, qelq, metale) pas seleksionimit, pastrimit, presimit ose riciklimit të pjesshëm, dorëzohen tek kompanitë përkatëse të licencuara për riciklim, të cilat i ripërdorin si lëndë të dytë në industrinë përkatëse (prodhim plastike, letre, qelqi apo metalesh). Në rastet kur mbetjet jo të riciklueshme mbeten si fraksion i mbetur, ato transportohen dhe deponohen në deponi sanitare të kontrolluara, të cilat janë të pajisura me sistem izolues, dhe monitorim të gazrave për të parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave.

e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjatë fazës së operimit te deponimi dhe djegia e mbeturinave

Përlllogaritja e mbetjeve dhe emetimeve gjatë fazës së operimit të deponimit dhe djegies së mbeturinave përfshin disa faktorë që ndikojnë në sasinë e ndotësve që lëshohen në ajër, ujë dhe tokë. Vlerësimi i saktë i këtyre emetimeve është jetik për të kontrolluar ndotjen dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore. Ja si mund të përlllogariten mbetjet dhe emetimet sipas llojit dhe sasisë:

Ajër: Gazrat nga djegiet motorike përmbajnë një numër të madh të komponentëve ndotëse me koncentracione të ndryshme por më të shprehur dhe më me ndikim në ndotje të ajrit janë CO, NO_x, HxCy, SO₂ dhe Pb. Ndotje të ajrit ndodh nga kundërmimet (era e pakëndshme) që lirohet nga mbeturinat e lartcekura. Ndikim tjetër me rëndësi në ajër paraqitet nga pluhurat që lirohen krijimi i hirit i cili krijohet nga proceset teknologjike të djegies së mbeturinave, si dhe depozitimi i tij. Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe numri i automjetet transportuese që transportojnë mbeturinat. Por kompania ka marrë disa masa gjatë operimit nuk parasheh ndotje shumë të madhe. Për eliminimin e erërave - kundërmimeve të ndryshme është bere vendosja e ventilatorëve, me qëllim që të bëhet ventilimi i hapësirës në të cilën është i vendosur Impianti, prandaj në njërën anë të murit janë vendosur ventilatorët me biofiltër për pastrimin e ajrit, kurse në anën tjetër të murit janë vendosur hapjet për hyrjen e sasisë së ajrit të pastër aq sa është nxjerrë me anë të ventilatorëve, gjithashtu aroma e pakëndshme zvogëlohet përmes ajrimit artificial përmes dritareve të të cilat janë vendosur në objekt. Bëhet kontrollimi i rregullt i pajisjeve për trajtimin e erërave të pakëndshme dhe sistemit të ventilimit pjesët e dëmtuara ndërrohen. Bëhet kontrollimi i rregullt teknik dhe mirëmbajtja e automjeteve transportuese që nevojiten për transportimin e mbeturinave medicinale nga institutet shëndetësore te komunave tjera gjer të Impianti, si dhe nga automjetet transportuese të cilat nevojiten për transportimin e mbeturinave të trajtuara gjer në deponin sanitare të mbeturinave, që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirim i gazrave nga automjetet e punës

të jetë sa më kualitativ.

Ujë: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës së kompanisë nuk ka pësuar ndryshime dhe nuk ka ndikuar negativisht ku ndotja është minimale, ujin e shfrytëzon nga ujësjellësi për qëllime sanitare, ndërsa për proces teknologjik e përdor nga pusi vetanak, kompania ka ndërmarr të gjitha masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave, për këtë që qëllim janë ndërtuar basenet. Gazrat, nga furra përmes gypave sipas përshkrimeve të bëra me lartë, barten deri tek basenet e ujërave, ku ndodhe neutralizimi i tyre.

Dheu: Gjatë fazës së operimit të fabrikës për trajtimin e mbeturinave, ndikim negativ në tokë paraqitet në aspektin e humbjes së sipërfaqes pjellore të tokës, mirëpo duke pasur parasysh pozitën ekzistuese të lokacionit që e kemi përmend në pasuset e më sipërme që për momentin për shkak të pozitës kjo tokë nuk punohet dhe krahasimin e përfitimit nga kjo sipërfaqe ky ndikim është i pa përfillshim, ndikim negativ në tokë paraqitet nga deponimi i dheut të gërmuar për kanale dhe bazamente, si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen nga materialet ndërtimore gjatë fazës së ndërtimit, mbeturinat e ngurta komunale të cilat i krijojnë punëtorët. Ndotja e tokës ndodhë nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga mundësia e derdhjes së naftës nga rezervari që nevojitet realizimin e procesit teknologjik për trajtimin termik të mbeturinave për ngrohje të objektit, nga derdhja e vajrave dhe derivateve nga automjetet ngarkuese dhe transportuese që nevojiten për transportimin e mbeturinave, transportimin e mbeturinave të trajtuara dhe transportimin e mbeturinave që mbeten si mbeturina që duhet dërguar në deponi.

Zhurma: gjatë operimit mund të ketë zhurmë gjatë lëvizjes së makinerive e cila është e pranueshme sipas normave, po ashtu edhe gjatë operimit është minimale.

Dridhjet: Dridhjet të tokës, tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi: Janë tri dukuri që të trijat së bashku të ndihmojnë në realizimin e punës ku Lokacioni ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “MetBat” SH.P.K. ka drite, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mirë e cila ndihmon në kursimin e energjisë elektrike.

Flora dhe Fauna: Në rast se kemi derdhje apo shkarkim nga ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal.

Ndikimet sociale dhe ekonomike: mund të themi lirisht se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal.

4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Duke e pasur parasysh se hapësira ku është ndërtuar fabrika për seleksionimin dhe ambalazhimin e plastikës, letrës, qelqit, metaleve si dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme “MetBat” SH.P.K. është përzgjedhur në atë mënyrë që të jetë sa më afër furnizimit me mbeturina, dhe njëkohësisht lokacioni të jetë sa më larg banimit, në mënyrë që të ruaj mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Me poshtë do të paraqesim disa alternativa të arsyeshme për të minimizuar ndikimet negative në mjedis dhe shoqëri:

Analiza e tregut: Kryerja e një analize të thelluar të tregut për të kuptuar kërkesat dhe tendencat e industrisë së menaxhimit të mbeturinave dhe riciklimit. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e llojit të shërbimeve që duhet të ofrohen dhe do të sigurojë që fabrika të operojë në mënyrë efikase dhe fitimprurëse.

Partneritetet me stacionet ekzistuese: Këto partneritete mund të lehtësojnë ndarjen e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit operativ, duke ulur kostot dhe rritur kapacitetin e përpunimit.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis: Kryerja e një vlerësimi të plotë të ndikimit në mjedis për të identifikuar efektet potenciale të aktiviteteve të fabrikës. Kjo do të ndihmojë në identifikimin e masave të nevojshme për të minimizuar ndikimet negative dhe për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret mjedisore.

Platformat në Internet dhe Shërbimet e Dorëzimit: Përdorimi i platformave online për ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e mbeturinave. Kjo mund të rrisë qasjen e klientëve dhe të përmirësojë efikasitetin e operacioneve, duke lehtësuar procesin e rezervimeve dhe ndihmuar në menaxhimin e mbetjeve.

Stimujt e Qeverisë: Identifikimi dhe përfitimi nga stimujt dhe subvencionet e ofruara nga qeveria për aktivitete mjedisore dhe riciklim. Këto stimuj mund të ndihmojnë në uljen e kostove dhe të mbështesin zhvillimin e praktikave të qëndrueshme.

Përmirësimi i së Ardhmes: Zhvillimi i strategjive afatgjata për rritjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të fabrikës në përputhje me nevojat e tregut dhe standardet mjedisore. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një pozite të fortë konkurruese dhe do të kontribuojë në një të ardhme më të qëndrueshme për kompaninë dhe mjedisin.

Këto alternativa të arsyeshme për lokacionin e “MetBat” SH.P.K. janë të dizajnuara për të maksimizuar përfitimet ekonomike dhe sociale, ndërsa minimizojnë ndikimet negative në mjedis. Implementimi i këtyre alternativave do të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe përgjegjës të fabrikës në komunitet.

5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Ndotja e mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: industria, ndërtimet ilegale, infrastruktura joadekuate, shtimi i numrit të automjeteve, importimi i automjeteve të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane si pasojë e menaxhimit të dobët, mungesa së riciklimit, etj. Duke konsideruar prezencën e shumicës së faktorëve të lartpërmendur, gjendja e mjedisit në komunën e Gllogocit nuk mund të konsiderohet në nivel të kënaqshëm. Industria e prodhimit të metaleve (NeWCo Feronikeli) është një nga industritë me ndikim më të madh mjedisor në Kosovë, edhe pse vërehet ulje e emisioneve që vijnë si rezultat i aktivitetit të tyre. Sektori i transportit dhe infrastrukturës së tij është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit ngase ndikon në fragmentimin dhe degradimin e habitateve (biodiversitetit), ndryshimin e peizazhit, shfrytëzimin e tokës dhe trashëgiminë kulturore. Kjo gjendje e kërcënon mjedisin duke shkaktuar ndotjen e ujit, ujërave nëntokësorë, ajrit dhe dheut. Si pasojë kemi dëmtimin e resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi joracional dhe pa kritere të ujit, tokës si dhe pyjeve është një tjetër çështje që duhet të konsiderohet si çështje serioze në të ardhmen. Është përgjegjësi komunale që të mbrojë dhe ruaj mjedisin natyror dhe jetësor (urban dhe rural) nga dëmtimi, degradimi apo ndotja si pasojë e veprimtarisë njerëzore ose të ndikimit natyror.

5.1 Flora dhe Fauna

Komuna e Gllogocit ka një pozite të mire gjeografike me një hidrografi të pasur dhe shtrihe mjaftë të madhe gjeografike, e cila përfshinë zonat mesatarisht të larta dhe zonal e ulëta të terrenit. Në këtë komunë, sa i përket biodiversitetit lidhur me llojet e bimëve këtu kemi mjaft larmishmerie të bimëve nga ato barishtore njëvjeçare deri te ato shumëvjeçare dhe drunore apo brezat të pyjeve. Nga brezi i shpërdhit me qarr shkon deri te brezi i ahut dhe shkozës. Brezi i pyjeve të shpërdhit me qarr bungut janë brezi me i dëmtuar nga faktori njeri. Ndërkaq në zonal e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqërime mjaftë të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin përgjatë rrugëve dhe vendbanimeve por, edhe barërat e këqija të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhënë afërsi të gjerdheve. Toka ku është ndërtuar fabrika e riciklimit dhe asgjësimit të mbeturinave ka një florë dhe faunë të mirë, por në rrethinën e fabrikës ka edhe shumë llojshmëri të ndryshme të bizneseve.

5.2 Hidrografia

Lumi kryesor që kalon nëpër komunën e Gllogocit është Drenica, e cila është degë e majtë e lumit Sitnica dhe i takon pellgut të Ibrit. Ajo buron në Bretenc te mali Cërralevë. Drenica që nga Gllogoci e deri në Bardh i Madh, hyn në një pjesë të ngushtë, duke marrë pamjen e një gryke. Në këtë pjesë të lumit pjerrtësia është më e madhe, gjerësinë më të madhe (10 m) dhe me pjerrtësi të butë derdhet në Sitnicë. Prurja mesatare e lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m³/s. Drenica ka dhe degëzimet e veta siç është Verbofc. Në territorin e komunës së Gllogocit ndodhet edhe Liqeni i Vasilevës. Gjithashtu, në territor të komunës gjendet edhe burimi i ujit mineral në Poklek me temperaturë 13.0°C, pH 6.3., rrjedhje 1.00l/sec dhe mineralizim 3.52 si dhe ai në Vërboc, lagjja Istog. Sipërfaqen e tokës pjellore të Luginës së Drenicës e mbulon sistemi i ujitjes “Ibër-Lepenc”. Klima - Kushtet klimatike janë mjaft të përshtatshme. Rajoni ka një klimë të mesme kontinentale me dimra të ftohtë dhe verë të ngrohtë me ndikime të klimës mesdhetare. Kjo vie nga pozita e komunës në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit. Rrafshi i Dukagjini ka klime me ndikime mesdhetare nga deti Adriatik, kurse ai i Kosovës ka klime kryesisht kontinentale. Temperatura mesatare vjetore është 10.6 °C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, kurse muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është afër 670 mm, kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV-IX) afër 330 mm.



Figura 5. Rrjeti Hidrografik i Komunës së Gllogocit

6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizimin e mënyrave se si aktivitetet e ndryshme industriale, si ato të "MetBat" SH.P.K., ndikojnë në ambient. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të ndikimeve të mundshme në mjedis. Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin e përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania "MetBat" SH.P.K.. Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

6.1 Ndikimet në ajër

Aktivitetet e "MetBat" SH.P.K, fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, Sankoc, Gllogoc, sjellin disa ndikime në ajër lidhen me gjenerimin e pluhurit gjatë seleksionimit, presimit dhe transportit të mbetjeve jo të rrezikshme, si dhe me emetimin e gazrave ndotës nga proceset e incinerimit dhe trajtimit kimik të mbetjeve të rrezikshme. Gazrat kryesorë janë CO₂, CO, NO_x, SO₂, pluhuri i imët (PM10/PM2.5), si dhe komponime organike të paqëndrueshme, të cilat në mungesë të filtrimit mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit.

6.2 Ndikimet në tokë

Aktivitetet e "MetBat" SH.P.K. Sankoc, K. Gllogoc, fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme sjellin disa ndikime negative në Tokë. Toka (dheu) si element themelor natyror është kusht ekologjik për rritjen dhe ekzistimin e bimëve, toka është element për prodhimin e ushqimit dhe ekzistimin e ekosistemit malor të cilët janë të nevojshëm për arritjen dhe mbajtjen e bilancit ekologjik (produktivitet dhe ndërtimit të materieve), posaçërisht për mbajtjen e stabilitetit mjedisor. Ndikimet në tokë vijnë nga depozitimi i përkohshëm i mbetjeve, rrjedhjet apo derdhjet e pakontrolluara të kimikateve dhe mbetjeve të rrezikshme, si dhe nga kontaminimi i mundshëm gjatë procesit të trajtimit. Zënia e hapësirës për infrastrukturën e përpunimit është një tjetër formë ndikimi në tokë, e cila redukton sipërfaqet me përdorim bujqësor apo natyror. Nga këto të dhëna vërehet se ndotja e tokës (dheut) nga

fabrika për trajtimin e mbeturinave varet para se gjithash nga rrjedhja e ujërave të ndotura nga sipërfaqet operuese, konfiguracioni i terrenit dhe nga sedimentimi i ndotjeve prej ajrit në rrethinë.

6.3 Ndikimet në ujë

Aktivitetet e “MetBat” SH.P.K. Sankoc, K.Gllogoc, fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, ndikimet në ujë lidhen me gjenerimin e ujërave teknologjike gjatë larjes dhe pastrimit të materialeve, me derdhjet e mundshme aksidentale të vajrave, tretësve ose kimikateve, si dhe me rrezikun e infiltrimit të ndotësve në ujërat nëntokësore. Në rastet kur ujërat e ndotura nuk trajtohen sipas standardeve, mund të shkaktohet ndotje e ujërave sipërfaqësore dhe ndikim mbi jetën akuatike.

6.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Kompania “MetBat” SH.P.K., duke operuar në fushën e trajtimit të mbeturinave, ka disa ndikime në peizazh, florë dhe faunë shfaqen si pasoja indirekte të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, duke ndikuar në cilësinë e habitatit dhe në gjendjen shëndetësore të faunës përreth. Zhurma, lëvizja e mjeteve dhe ndriçimi artificial mund të shkaktojnë shqetësime për shpendët dhe kafshët e egra, ndërsa mbetjet e rrezikshme të pa trajtuara mund të shkaktojnë dëmtime serioze në biodiversitet.

6.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku është ndërtuar objekti të cilin e shfrytëzon kompania “MetBat” SH.P.K. nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku është bërë ndërtimi është largë vendbanimeve. Por prapë ndikimet mund të lidhen me ekspozimin e mundshëm të komunitetit ndaj pluhurit, erërave të pakëndshme, emetimeve të gazrave dhe rrezikut nga aksidentet teknologjike. Nga ana tjetër, projekti sjell ndikime pozitive si hapja e vendeve të reja të punës dhe rritja e ekonomisë lokale.

6.6 Ndikimet nga zhurma

Kompania “MetBat.P.K. Sankoc, K.Gllogoc fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin e nervor, në hipertension, në koncentrim e njeriut në punë etj. Ndikimet nga zhurma krijohen kryesisht nga operimi i makinerive të presimit, shredder-ëve, incineratorëve dhe nga qarkullimi i mjeteve

transportuese. Nëse nuk kontrollohen, nivelet e zhurmës mund të tejkalojnë kufijtë e lejuar dhe të ndikojnë në cilësinë e jetës së popullatës përreth. Edhe me herët e cekem që kjo kompani ndodhet larg vendbanimeve, dhe zhurma me e madhe shkaktohet nga zhurma e shkaktuar nga rruga, magjistralla M9.

6.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Kompania “MetBat” SH.P.K. Sankoc, K.Glllogoc, fabrikë për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, gjasat e ndodhjes së aksidentit vlerësohen në bazë të dhënave mbi ngjarjet dhe aksidentet në pajisjet (stabilimentet) e njëjta ose të ngjashme në vendet tjera dhe të dhënave të përfituara nëpërmjet identifikimeve të rreziqeve. Ndikimet në rastet e aksidenteve mjedisore janë ndër më seriozet, pasi derdhjet e kimikateve, shpërthimet apo zjarret mund të shkaktojnë ndotje të përhapur në ajër, ujë dhe tokë, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin e njerëzve dhe në ekosistem. Rreziku rritet sidomos kur magazinimi i mbetjeve të rrezikshme bëhet në mënyrë të pasigurt.

6.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

Ndikimet nga mbeturinat lidhen me menaxhimin jo të duhur të fraksioneve të mbetura pas procesit (hi nga incinerimi, precipitate kimike, llumra, mbetje të presuara jo të riciklueshme). Nëse nuk deponohen në mënyrë të kontrolluar, ato mund të shkaktojnë ndotje afatgjatë në tokë dhe ujë. Po ashtu në këtë kompani përpos mbeturinave pas procesit teknologjik, krijohen edhe mbeturinat nga punëtorët, të cilat janë mbeturina komunale, këto mbeturina ruhen në kontejner të mbuluar, dhe mirën nga kompania për menaxhimin e mbeturinave komunale. Të gjitha mbeturinat në këtë kompani klasifikohen sipas katalogut shtetëror të mbeturinave. Me poshtë do paraqesim kodet e mbeturinave sipas katalogut shtetëror të mbeturinave, ku do paraqesim vetme mbeturinat e krijuara nga punëtorët dhe jo ato të cilat hyn në proces teknologjik, sepse i kemi të përmendura më lartë.

Tabela 2 Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror vetëm ato të krijuara nga punëtorët

Mbeturinat sipas katalogut shtetëror			
Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Emri i Mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i planifikuar për deponimi të mbeturinave
20 01 01	Letër dhe karton	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 03 01	Mbeturina të përziera komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
20 01 39	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Mbeturinat me nr. 20 01 01 dhe 20 01 39 behet asgjësimi i tyre ne fabrike ndërsa vetëm mbeturinat komunale dërgohen ne deponine regjionale.

6.9 Trashëgimia Kulturore

Si pas hulumtimit te materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar ne teren dhe komunë, ne lokacionin e ngushte, ku gjendet fabrika e kompanisë “MetBat” SH.P.K., nuk kemi monumente te trashëgimisë kulturore, historike e natyrore te cilat eventualisht do te ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë se kompanisë ne fjale.

7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS

Pasojat e mundshme në mjedis nga aktivitetet e përpunimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme lidhen drejtpërdrejt me natyrën e procesit teknologjik, llojin e mbetjeve dhe masat e zbatuara për parandalim. Në rast të moszbatimit të standardeve teknike dhe mjedisore, pasojat mund të jenë të konsiderueshme dhe me efekte afatgjata.

Pasojat në ajër mund të shfaqen si ndotje nga emetimet e pluhurit, gazeve dhe komponimeve organike të paqëndrueshme (VOC), duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe duke kontribuar në ndryshimet klimatike. Emisionet e pakontrolluara të dioksinave, furanëve dhe metaleve të rënda nga proceset e incinerimit do të përbënin rrezik serioz për shëndetin publik.

Pasojat në ujëra përfshijnë ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga derdhjet aksidentale, infiltrimi i kimikateve ose shkarkimi i ujërave të patrajtuara. Kjo mund të shkaktojë degradimin e ekosistemeve ujore, rrezikim të florës dhe faunës akuatike, si dhe ndikime në furnizimin e komuniteteve me ujë të pijshëm.

Pasojat në tokë lidhen me kontaminimin nga substanca toksike, metale të rënda dhe kimikate të rrezikshme, duke e bërë tokën të papërshtatshme për përdorim bujqësor dhe duke ndikuar në bioakumulimin e ndotësve në zinxhirin ushqimor.

Pasojat në biodiversitet dhe peizazh lidhen me humbjen e habitatit, dëmtimin e specieve të ndjeshme nga ndotja, si dhe me ndryshimin estetik të peizazhit nëse mbetjet menaxhohen në mënyrë jo të kontrolluar. Emisionet dhe zhurmat mund të shqetësojnë shpendët dhe kafshët e egra, duke çuar në largimin e tyre nga zonat përreth.

Pasojat në popullatë dhe vendbanime mund të përfshijnë ekspozimin e banorëve ndaj ndotësve të ajrit, ujit dhe tokës, rritjen e rrezikut për sëmundje respiratore, dermatologjike dhe

toksikologjike, si dhe uljen e cilësisë së jetës. Nga ana tjetër, projekte të tilla kanë edhe pasoja pozitive, duke krijuar vende pune dhe përmirësuar sistemin e menaxhimit të mbetjeve.

Pasojat nga zhurma dhe dridhjet lidhen me shqetësimin e komuniteteve të afërta, duke ndikuar në shëndetin psikofizik të popullatës në rast të mungesës së masave izoluese.

Pasojat nga aksidentet mjedisore janë ndër më të rrezikshmet: derdhje të kimikateve, zjarre ose shpërthime që mund të shkaktojnë ndotje të përhapur dhe dëme të parikuperueshme në mjedis.

Pasojat nga mbeturinat e mbetura pas procesit (hi, llumra, precipitate, mbetje të paklasifikueshme) mund të jenë të dëmshme nëse nuk deponohen në deponi të posaçme të mbrojtura, duke rritur ndotjen afatgjatë të tokës dhe ujërave.

Pasojat në trashëgiminë kulturore janë më të rralla, por mund të shfaqen në rastet kur aktiviteti zhvillohet pranë zonave me vlera kulturore, përmes vibrimeve, ndotjes së ajrit dhe transformimit të peizazhit, të cilat ndikojnë në ruajtjen e integritetit të këtyre vlerave.

8. PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:

➤ Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore

Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:

- Studimi dhe Analiza: Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.
- Raportimi: Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.
- Konsultimi: Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë komente dhe për të siguruar transparencë.

➤ Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:

- Planifikimi: Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.
- Implementimi: Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.
- Kontrolli dhe Monitorimi: Monitorimi i performancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.
- Përmirësimi: Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar performancën mjedisore.

➤ **Analiza e Ciklit të Jetës**

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

- Hulumtimi i Ndikimeve: Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
- Krahësimi: Krahësimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
- Raportimi: Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

➤ **Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore**

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

- Analiza e Rrezikut për Shëndetin: Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
- Studimi i Efekteve në Komunitet: Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

➤ **Analiza e Rrezikut Ambientale**

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

- Identifikimi i Rreziqeve: Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhishë së incidenteve ndotëse.
- Vlerësimi i Pasojave: Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhishë së këtyre incidenteve.

9. PERSHKRIMI I MASAVE

Përpunimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme shoqërohet me një sërë ndikimesh potenciale në ajër, ujë, tokë, biodiversitet dhe shëndetin e popullatës. Për këtë arsye, zbatimi i **masave parandaluese dhe zvogëluese** është thelbësor për të garantuar funksionimin e sigurt dhe në përputhje me kërkesat ligjore e mjedisore.. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejme të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut nga fabrika për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

9.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të zvogëluar ndikimet negative në ajër nga aktivitetet e kompanisë “MetBat” SH.P.K., mund të merren disa masa për mbrojtjen e ajrit, që përfshijnë përdorimin e sistemeve të filtrimit (filtra me qese, filtra HEPA, elektrostatikë) dhe scrubber-a të lagësht për largimin e pluhurit dhe gazeve acidikë. Incineratorët duhet të pajisen me dhomë të dytë djegieje dhe sisteme për kontrollin e dioksinave e furanëve, ndërsa monitorimi i vazhdueshëm i emetimeve (CEMS) duhet të sigurojë që kufijtë ligjorë të mos tejkalohen.

9.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Për të zvogëluar ndikimet negative në ujë nga aktivitetet e “MetBat” SH.P.K., mund të merren disa masa efektive **për mbrojtjen e tokës** përfshijnë magazinimin e mbetjeve në sipërfaqe të papërshkueshëm nga uji, përdorimin e paletave sekuestruese për kontejnerët me kimikate dhe ndërtimin e barrierave të betonuara për të shmangur infiltrimin e substancave ndotëse. Gjithashtu, duhet të respektohet ndarja e mbetjeve të rrezikshme dhe të pa rrezikshme për të shmangur reaksionet kimike.

9.3 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë

Për të minimizuar ndikimet negative në ujë nga fabrika “MetBat” SH.P.K. janë të domosdoshme disa masa për mbrojtjen e ujërave konsistojnë në ndërtimin e sistemeve të trajtimit të ujërave teknologjike (neutralizim kimik, sedimentim, koagulim-flokulim, trajtim biologjik), si dhe vendosjen e pishinave sekuestruese dhe gropave mbledhëse për parandalimin e derdhjeve aksidentale. Shkarkimi i ujërave duhet të bëhet vetëm pasi të arrihen parametrat e përcaktuar në UA Nr. 02/2022 për shkarkimin e ujërave të ndotura.

9.4 Masat për mbrojtje nga zhurma

Për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e punonjësve nga ndikimet negative të zhurmës, janë të nevojshme disa masa efektive si përdorimin e makinerive me efikasitet akustik, izolimin e

pajisjeve me panele zë-absorbues, kryerjen e transportit në orare të përshtatshme dhe monitorimin periodik të niveleve të zhurmës për të siguruar që ato janë brenda kufijve ligjorë.

9.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Për të mbrojtur peizazhin, florën dhe faunën, “MetBat” SH.P.K, duhet të marrë disa masa të rëndësishme si: mbjelljen e gjelbërimit përreth zonës industriale për të reduktuar pluhurin dhe zhurmën, ndriçimin e kontrolluar për të shmangur shqetësimin e faunës, si dhe sigurimin që mbetjet e trajtuara të mos ndikojnë në habitatet natyrore përreth.

9.6 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Për të zvogëluar ndikimet negative në vendbanime dhe popullatë nga aktivitetet e “MetBat” SH.P.K., mund të merren disa masa që përfshijnë përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale (PPE), trajnimin e stafit për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme, instalimin e sistemit të ventilimit dhe alarmit për gazrat toksikë, si dhe krijimin e perimetrit mbrojtës ndërmjet objektit dhe zonave të banuara.

9.7 Masat për menaxhimin e mbeturinave

Kompania “MetBat” SH.P.K fabrikës për rikuperimin e materialeve të klasifikuara, grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, Sankoc, K.Gllogoc, klasifikimi i mbeturinave bëhet sipas kodeve të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave.

Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimin të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060. Menaxhimin me vajrat mbeturinë të cilat grumbullohen dhe të vendosen në fuqi të mbyllura dhe të siguruara. Menaxhimin me mbeturina komunale të cilat grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor. Klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligj të mbeturinave, Nr.04/L-060

Menaxhimin me mbeturina të ngurta komunale bëhet, klasifikohen dhe të vendosen në

kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

Plani i menaxhimit me mbeturina përfshinë aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, Plani për menaxhimin e mbeturinave përmban, masat e zbatuara me qëllim të parandalimit të krijimit të mbeturinave, zvogëlimin të sasisë së tyre zbatimin e masave dhe teknikave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut, përcaktimin e mënyrës për magazinimin, trajtimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave.

9.8 Masat rehabilituese

Për të zvogëluar ndikimet negative dhe për të rehabilituar mjedisin pas aktiviteteve industriale, “MetBat” SH.P.K. mund të ndër marrë masat e mëposhtme:

- **Rikuperimi i Habitatit** - Mbjellja e bimëve vendase për të rikuperuar ekosistemet natyrore dhe për të rivendosur biodiversitetin. Formimi i hapësirave të gjelbra që ofrojnë strehim për faunën dhe përmirësojnë cilësinë e ajrit.
- **Trajtimi i Tokës** - Përdorimi i teknologjive për të pastruar tokën nga ndotësit, përfshirë teknikat e bioremedimi dhe fitoremendimi. Implementimi i masave për të parandaluar erozionin, si ndërtimi i barrierave dhe mbjellja e bimëve për stabilizim.
- **Menaxhimi i Ujërave** - Zhvillimi i sistemeve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe riciklimin e ujit për përdorim të sigurt.
- **Monitorimi dhe Vlerësimi** - Krijimi i një programi të vazhdueshëm për të monitoruar cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës pas rehabilitimit. Publikimi i të dhënave për të informuar publikun dhe për të siguruar transparencë në proceset e rehabilitimit.
- **Edukimi dhe Ndërgjegjësimi** - Ofrimi i trajnimeve për punonjësit mbi metodat e rehabilitimit dhe ruajtjes së mjedisit. Organizimi i aktiviteteve për të edukuar komunitetin mbi rëndësinë e rehabilitimit të mjedisit dhe mënyrat për të kontribuar.

9.9 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktjnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkaktin ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial për rritje e ndotjes së ajrit nga pluhuri dhe gazrat ndotës (CO ₂ , NO _x , SO ₂ , PM10/PM2.5, VOC, dioksina.	Proceset e incinerimit, djegia e karburanteve, ngarkim-shkarkimi i mbetjeve, transporti.	Instalimi i sistemeve të filtrimit (scrubber, filtra me qese, HEPA, elektrostatikë), djegie dytësore në >1100°C, mirëmbajtje e mjeteve, monitorim CEMS.
Uji dhe Toka	Ndotje nga derdhje aksidentale, infiltrime, shkarkime të ujërave të patrajtuara. Kontaminim nga derdhjet e mbetjeve, vajrave, kimikateve ose hirit.	Larja e pajisjeve, proceset teknologjike të larjes së plastikës, rrjedhje vajrash e kimikatesh, reshje mbi zonat e mbetjeve. Depozitimi i përkohshëm i mbetjeve, transporti dhe ngarkim-shkarkimi, rrjedhje aksidentale	Ndërtimi i sistemeve të trajtimit (neutralizim, sedimentim, trajtim biologjik), bazamente të papërshkueshëm nga uji, pishina sekuestruese, monitorim i rregullt i parametrave. Magazinim mbi sipërfaqe te papërshkueshëm nga uji, përdorimi i paletave sekuestruese, plan reagimi emergjent, ndarje e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e	Humbje ose dëmtim i habitatit, stres nga ndotja, zhurma dhe drita artificiale.	Ndotja e ajrit, tokës dhe ujërave, gjate proceseve teknologjike, drita dhe lëvizjet e mjeteve.	Zonim mbrojtës, menaxhim i ndotjes sipas standardeve, gjelbërim për reduktimin e ndikimeve, ndriçim i kufizuar natën.

mbrojtura të natyrës)			
Zhurma	Potencial minimal	Funksionimi i makinerive (presa, shredder, incineratorë), qarkullimi i mjeteve transportuese.	Izolim akustik, përdorim i makinerive me standarde akustike, orare të përshtatshme pune, mbjellje gjelbërimi përreth.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial minimal	Emisionet nga proceset, transporti, incinerimi, ruajtja e mbetjeve të rrezikshme.	Pajisje mbrojtëse për punëtorët (PPE), buffer zone ndërmjet impiantit dhe zonave të banuara, sistem alarmi dhe ventilimi, plan emergjent.

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Proceset e përpunimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, pavarësisht aplikimit të masave mbrojtëse, shoqërohen me një sërë pasojash potencialisht negative në komponentët kryesorë të mjedisit. Këto pasoja lidhen me natyrën e mbetjeve, karakterin e proceseve teknologjike dhe mundësinë e aksidenteve gjatë operimit. Në ajër, ndikimet mund të manifestohen përmes emetimit të pluhurit dhe gazeve ndotëse, të cilat në rast se nuk filtrohen siç duhet, ndikojnë në cilësinë e atmosferës dhe shëndetin publik. Në ujë, rreziku kryesor vjen nga derdhjet aksidentale ose infiltrimi i substancave toksike që mund të dëmtojnë ekosistemet ujore dhe të rrezikojnë furnizimin me ujë të pijshëm. Në tokë, pasojat negative lidhen me ndotjen nga ruajtja e papërshtatshme, derdhjet apo deponimi jo i kontrolluar, të cilat mund ta bëjnë tokën të papërdorshme për një periudhë afatgjatë. Po ashtu, flora dhe fauna mund të preken nga ndotja, nga zhurma dhe dridhjet, si dhe nga ndryshimet në habitatet përreth zonës së aktivitetit. Ndikime të ndjeshme mund të ketë edhe tek vendbanimet dhe popullata, përmes ekspozimit të mundshëm ndaj ndotësve ose rrezikut nga aksidentet teknologjike si zjarret dhe shpërthimet. Edhe pse këto pasoja mund të reduktohen me masa të përshtatshme teknike dhe organizative, ato mbeten gjithnjë një potencial real që kërkon menaxhim dhe monitorim të vazhdueshëm.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe raportimi përbëjnë një komponent thelbësor të menaxhimit mjedisor gjatë procesit të përpunimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, me qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të ndikimeve dhe verifikimin e përputhjes me standardet ligjore. Monitorimi kryhet në mënyrë të rregullt mbi cilësinë e ajrit, ujërave, tokës, zhurmës dhe mbetjeve të mbetura nga proceset teknologjike. Në ajër, vëzhgohen emisionet e gazrave dhe pluhurit përmes sistemeve të matjes së vazhdueshme (CEMS), duke kontrolluar parametrat si CO₂, CO, NO_x, SO₂, pluhur të imët dhe komponime organike të paqëndrueshme. Ujërat monitorohen për pH, BOD₅, COD, metale të rënda dhe parametra të tjerë sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2022 për shkarkimin e ujërave të ndotura. Tokat dhe ujërat nëntokësore testohen periodikisht për të identifikuar ndonjë kontaminim nga derdhjet apo infiltrimet, ndërsa për zhurmën kryhen matje akustike në kufi të objektit për të siguruar që niveli i saj mbetet nën kufijtë e lejuar.

Monitorimi përfshin gjithashtu edhe mbetjet e ngurta dytësore (hi, llumra, precipitate), të cilat analizohen për përmbajtjen e substancave të rrezikshme përpara deponimit final. Procesi shoqërohet me mbajtjen e regjistrave të detajuar për sasinë, llojin dhe trajtimin e çdo mbetjeje, të cilat shërbejnë për raportim zyrtar.

Raportet mjedisore përgatiten sipas kërkesave të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe organeve inspektuese, zakonisht në baza tremujore ose vjetore, dhe përmbajnë të dhëna mbi rezultatet e monitorimit, krahasimin me standardet ligjore, masat e zbatuara dhe rekomandimet për përmirësim.

Ky sistem siguron kontroll dhe transparencë, duke i mundësuar autoriteteve dhe komunitetit të kenë informacion të qartë mbi ndikimet reale në mjedis, si dhe garanton që operatori të ndërmarrë masa korrigjuese në rast të tejkalimit të kufijve të lejuar.

12. PËRFUNDIM

Duke i analizuar të gjitha parametrat e procesit të punës në objektet Fabrikë për seleksionimin dhe ambalazhimin e plastikës, letrës, qelqit, metaleve si dhe djegien e mbeturinave medicinale - barnave me afat të skaduar (Rritja e Kodeve shtese) që ndodhet në Fushë Kosovë, përfaqësojnë një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, por njëkohësisht përbëjnë edhe burim të mundshëm ndikimesh negative nëse nuk menaxhohen në mënyrë të kontrolluar. Nga analiza e bërë rezulton se ndikimet kryesore lidhen me ndotjen e ajrit, ujit, tokës, ndikimin në biodiversitet dhe shëndetin e popullatës, si dhe me rreziqet që burojnë nga aksidentet mjedisore. Po ashtu, gjatë procesit teknologjik krijohen mbetje dytësore, hi, llumra apo precipitate që kërkojnë trajtim dhe deponim të posaçëm.

Megjithatë, me zbatimin e teknologjive bashkëkohore, aplikimin e masave parandaluese e zvogëluese, si dhe me një sistem të rregullt të monitorimit dhe raportimit, këto ndikime mund të reduktohen në nivele të pranueshme dhe të menaxhueshme. Zbatimi i standardeve ligjore dhe mjedisore, menaxhimi i kujdesshëm i magazinimit, transportit dhe trajtimit, si dhe përfshirja e planeve emergjente për raste aksidentesh sigurojnë jo vetëm mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, por edhe përfitime ekonomike e sociale nëpërmjet riciklimit dhe rigjenerimit të materialeve të vlefshme.

Në përfundim, projekti për përpunimin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme mund të zhvillohet në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, duke minimizuar ndikimet negative dhe duke maksimizuar përfitimet për mjedisin dhe komunitetin, për aq kohë sa masat e propozuara zbatohen me përpikëri dhe monitorimi realizohet në vazhdimësi.

Tabela e kodeve ekzistuese të mbeturinave dhe atyre shtese të kërkuara nga Kompania.

Tabelave e kodeve me Leje dhe Atyre shtesë të kërkuara					
01 04 13	09 01 10	16 01 03	17 04 05	18 02 05*	20 01 27*
02 01 04	10 03 05	16 01 07	17 04 06	18 02 07*	20 01 28
02 01 10	15 01	16 01 19	17 04 07	18 02 08	20 01 29*
02 03	15 01 01	16 01 20	17 06 01*	19 12 01	20 01 30
02 03 99	15 01 02	16 04 02*	17 06 03*	19 12 02	20 01 31*
03 01	15 01 03	16 06 01*	17 06 05*	19 12 03	20 01 32
03 01 01	15 01 04	16 06 04	18 01 01	19 12 04	20 01 33*

03 03 08	15 01 05	16 06 05	18 01 02	19 12 05	20 01 34
04 01	15 01 06	16 08 01	18 01 03*	19 12 06*	20 01 35*
04 01 01	15 01 07	17 02 01	18 01 04	19 12 07	20 01 36
04 01 09	15 01 09	17 02 02	18 01 06*	19 12 08	20 01 39
04 02 09	15 01 10*	17 02 03	18 01 08*	20 01 01	20 01 40
07 02 13	15 01 11*	17 02 04*	18 01 09	20 01 02	
09 01 06*	15 02	17 04 01	18 02 01	20 01 10	
09 01 07	15 02 02*	17 04 02	18 02 02	20 01 11	
09 01 08	15 02 03	17 04 03	18 02 03	20 01 19*	

Duke u bazuar në natyrën e punës së fabrikës dhe aktivitetit të sajë, vendndodhjen, kapacitetin dhe intensitetin e veprimeve, mund të konstatohet se ndikimet në mjedisin lokal janë të kontrollueshme. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor për rritjen e numrit të kodeve sipas kërkesës së investitorit – Fabrikë për seleksionimin dhe ambalazhimin e plastikës, letrës, qelqit, metaleve si dhe djegien e mbeturinave medicinale - barnave me afat të skaduar që ndodhet në Harilaq, Komuna e Fushë Kosovës.

13. FORMA TABELARE E KOSTOS INVESTIVE

KOSTO INVESTIVE PER KATËR OBJEKTET		
1	Ndërtimi i Objekteve	117000
2	Peshorja Elektronike	56500
3	Furra Rrotulluese ZUG, kapaciteti 6 kubik	97000
4	Furra Rrotulluese ZUG, kapaciteti 12 kubik	111000
5	Furra Rrotulluese HUETER, kapaciteti 40 kubik	157000
6	Furra për shkrirjen e bakrit.	114000
7	Rezervuari i Oksigjenit	59000
8	Cikloni para filtrave me diametër 2.8 metra	54000
9	Filtër elektrostatik pllakezor – Heinrich LUHR-MST	59000
10	Filtër me thasë BMD Garant – DISA Technology	61000
11	Skruberi me ujë dhe me rezervuar me MISS NET diametër 2.5 metra dhe lartësi të MISS NET 1.5 metra.	55000
12	Oxhaku me diametër 1.2 metra dhe lartësi 24 metra.	44000
Kosto totale investive për te katër objektet		984,500.00 €

“MetBat” SH.P.K.

Sankoc, Komuna Glllogoc

14. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- *Te dhënat nga Investitori,*
- *PZHK-Drenas-16.06.20-min.size_.pdf*
- *Kërko dhe paraqit - KGP*
- *Hartë*
- *Google Maps*
- *LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS (rks-gov.net)*
- *UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHETËROR TË MBETURINAVE*